



qendra e provimeve

SHIFRA E NXËNËSIT

## PROVIMI I MATURËS

QERSHOR 2018

# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

## U D H Ë Z I M

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i pajisjeve elektronike.  
Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.  
Testi **DUHET** të zhvillohet me laps kimik i cili nuk mund të fshihet.

Testi përmban detyra në të cilat do të përgjigjeni në njërën prej këtyre mënyrave:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë.


Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes t'i përshkruash përgjigjet tuaja.

**Detyra do të vlerësohet me (0) pikë nëse:**

- është e pasaktë
- janë rrethuar më shumë përgjigje të ofruara
- është e palexueshme dhe e paqartë
- zgjidhja është shkruar me laps të thjeshtë

Nëse gabon vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh zgjidhjen e testit, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tuaja. Me fat!

**Me fat!**



\* A 8 5 9 1 5 \*

REPEATED PHRASES: 2018PROVIMIIMATU... (The text consists of a continuous, dense stream of this specific alphanumeric sequence repeated across the entire page.)

# FAQE E ZBRAZËT

## PARATHËNIE

Kur shkrimtarit më të mirë anglez të dramës të shekullit XVIII Riçard Brinzli Sheridan ia treguan librin me përzgjedhjet e teksteve të Shekspirit me titull *Bukuritë e Shekspirit*, ai pyeti: “Po ku janë njëmbëdhjetë vëllime të tjera?”. Hartuesi i çfarëdo përzgjedhjeje të ngushtë të dramave të Shekspirit është i vetëdijshëm se mund t’i parashtrohet një pyetje e ngjashme. Ai gjithashtu është i vetëdijshëm se është shumë e vështirë, madje ndoshta edhe e pamundur, të mbrohet jo ajo që në përzgjedhje të vet ka futur, por ajo që ka lënë jashtë. Vërejtjet e mundshme të lexuesve që në këtë libër do t’i kërkojnë kot kryeveprat e tilla sikurse janë *Tregtari i Venedikut, Ëndrra e një nate vere, Antoni e Kleopatra* ose *Përralla dimërore* redaktori mund t’i kuptojë plotësisht. Mungesa e hapësirës mund të ofrohet si një justifikim, por jo edhe ngushëllim. Ajo që mund të konsiderohej si një ngushëllim është që asnjë përzgjedhje e këtij vëllimi nga vepra e ndonjë shkrimtari individual nuk do të përmbante kaq shumë vepra të vlerës më të lartë letrare.

Me rastin e përgatitjes së këtij libri dëshira ishte që krijimtaria e Shekspirit të paraqitet në format e saj të ndryshme. Janë përfshirë dramat më të mira nga të gjitha zhanret që i përdorte ai. Me këtë rast, kryesisht është shkruar edhe rrjedha zhvillimore e artit të tij. Në periudhën e hershme Shekspiri shkruante kryesisht drama historike dhe komedi. Dramat më të mira të tij të bazuara në historinë angleze janë *Rikardi III* dhe pjesa e parë dhe e dytë *Henriku IV*. Komeditë, të cilat gjithashtu i ka shkruar në periudhën e parë, janë të prezantuara me dy drama - *Si të doni* dhe *Nata e dymbëdhjetë* – të cilat konsiderohen filizat më fisnike të gjenit të komediografisë së Shekspirit. Në vitet e mëvonshme Shekspiri ka shkruar tragjedi dhe të ashtuquajturat drama problemore. Tipin e parë të dramës këtu e përfaqësojnë *Romeo* dhe *Zhuljeta* dhe katër pjesë të cilat e përbëjnë grupin e quajtur thjeshtë “tragjeditë e mëdha” – *Hamleti, Othello, Makbethi* dhe *Mbreti Lir*. Dramat problemore, të shkruara për afërsisht në të njëjtën kohë, janë prezantuar me *Troilon* dhe *Kresidën*. Nga periudha e mëvonshme e krijimtarisë së Shekspirit është përzgjedhur tragjikomedia *Stuhia*, sipas të gjitha gjasave drama e fundit që e kishte shkruar vetë Shekspiri.

Disa nga këto drama tek ne janë përkthyer disa herë. Këtu janë sjellë përkthimet të cilat janë më të mirat për mendimin e botuesit.

Në shënimet, në fund të faqes, janë dhënë shpjegimet të cilat i kanë dhënë përkthyesit.

V.K.

**1.** Cilat vepra të Shekspirit nuk janë prezantuar në këtë botim, e që janë përmendur në tekst?

---

---

1 pikë

**2.** Përshkruaji titujt e dy komedive të cilat gjenden në këtë botim.

---

1 pikë

**3.** Me cilin qëllim botuesi e ka bërë këtë përzgjedhje të veprave të Shekspirit?

1. Që të prezantohen veprat me vlerë më të lartë letrare.
2. Që të përfaqësohen dramet më të mira e të gjitha zhanreve.
3. Që të tregohet në grupin e quajtur “tragjeditë e mëdha”.

*Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.*

1 pikë

**4.** Nëse konstatimi është i saktë, rretho S, ndërsa nëse është i pasaktë, rretho P dhe argumentoje përgjigjen.

KONSTATIMI	SAKTË PASAKTË	ARGUMENTIMI I PËRGJIGJES
Në këtë botim është edhe drama problemore <i>Romeo dhe Zhulieta</i> të cilën Shekspiri e ka shkruar në vitet e vonshme	S      P	

1 pikë

**Duke shfrytëzuar tekstin zhvillo detyrat 5, 6, 7 dhe 8.**

1. \_\_\_\_\_ (titulli)

2. \_\_\_\_\_ (nëntitulli)

Kurrë nuk do ta harroj këshillin më të mirë lidhur me karrierën të cilin e kam marrë ndonjëherë. Kam qenë një docent i ri në Shkollën e Biznesit të Harvardit, i etshëm të zbuloj çfarë do të mund të bëja që të “bëhem partner” (d.m.th. që të fitoj lëndën time). Kam shkuar te një nga “burrështetasit” në moshë në mënyrë që të mësoj se çfarë kërkohet nga unë.

“Je duke shtruar pyetje të gabuar, Dejvid”, tha ai. “Këtu rregulla është shumë e thjeshtë. Nëse pjesa tjetër e botës është duke të kërkuar, me gjasë do të kërkojmë edhe ne. Nëse pjesës tjetër të botës nuk i duhesh, sipas të gjitha gjasave nuk do të na duhesh as neve. Përqendroju që të jesh më i miri në atë që dëshiron ta bësh”.

Në atë kohë kam menduar se një përgjigje e këtillë është dredharake dhe e pakënaqshme. “Por, në çfarë të përqendrohemi?”, pyeta. “A duhet që të zgjedh ndonjë disiplinë funksionale, ndonjë specialitet industrial, ose diçka tjetër?” “Ajo varet nga ti” është përgjigjur ai. “Puno çfarë të duash me çka mund të kënaqesh. Mos merr atë me të cilën nuk do të kënaqesh, vetëm për shkak të asaj që mendon se ne jemi duke e kërkuar.”

Nga pak skeptik, megjithatë e kam dëgjuar këshillën e tij dhe kjo më çoi, shumë vite më vonë, deri në pikën në të cilën më me dëshirë e kam zgjedhur karrierën konsultuese sesa të vazhdoj me atë akademike. Kënaqesha në çdo minutë që kam kaluar në Harvard, dhe gjithashtu jam kënaqur edhe në çdo minutë prej kohës që jam larguar.

Si kaluan dekadat, kuptova mençurinë e thellë të asaj që më tha ky njeri. Porosia është e thjeshtë: suksesi vjen nëse punoni atë në të cilën kënaqeni. Nëse nuk kënaqeni në atë, si mund të quhet sukses?

3. \_\_\_\_\_ (nëntitulli)

Shumë njerëz i qasen planifikimit të karrierës së tyre (ose biznesit) si një ushtrimi analitik për atë cilat tregje rriten dhe për të cilat shërbime ekziston kërkesa. Megjithëse këto janë të dhëna të rëndësishme, besoj se planifikimi i karrierës nuk është detyrë primare analitike.

Gjykuar sipas vëzhgimeve të mia të ekspertit, është plotësisht e qartë se suksesi nuk vjen domosdoshëm tek ata me koeficient më të lartë të inteligjencës, as tek ata që ndoqën shkollat më të mira, madje as tek ata që zgjodhën specialitetin më popullor. Përveç nëse nuk punoni në diçka që doni, është e vështirë të gjeni një disiplinë ku do ta tregoni entuziazmin tuaj.

Ky mendim nuk është i ri. Shpesh theksohet citimi i ish presidentit të SHBA-së Kelvin Kulixh: “Asgjë në botë nuk mund ta zëvendësojë këmbënguljen. Talenti nuk do ta bëjë këtë – nuk ka asgjë më të zakonshme sesa njerëzit e pasuksesshëm, dhe të talentuar. As gjeniu nuk do ta bëjë këtë – gjeniu i pashpërblyer është gati një proverb. Nuk do ta bëjë këtë as arsimimi – bota është përplot me njerëz të arsimuar dhe të braktisur. Vetëm këmbëngulja dhe vendosmëria që të bëni diçka janë të plotfuqishme.”

Me fjalë të tjera, ajo që ju intereson. Mos u shqetësoni për atë që jeni i mirë: nëse diçka ju nxit, në atë do të jeni mjaft të mirë. Dhe, nëse nuk ju nxit – nuk do të jeni të mirë. “Forcat” tuaja janë të parëndësishme: atë që e doni, kjo është vendimtare.

*(Përgatitur sipas tekstit të David H. Maisterit, në revistën drejtori, 10/996)*

- 5. Në bazë të tekstit të lexuar në vendet përkatëse (në faqen 9) radhiti dhe shkruaje titullin dhe nëntitujt: *Planifikimi i karrierës; Këshillat për një karrierë të suksesshme; Për suksesin në punë vendimtare është dashuria.***

*1 pikë*

- 6. Cilën këshillë e ka marrë docenti i ri lidhur me karrierën?**

---



---

*1 pikë*

- 7. Pranë konstatimeve të dhëna në tekst të cilat janë vendimtare për sukses në punë rretho PO, ndërsa nëse nuk janë vendimtare për sukses, rretho JO.**

KONSTATIMI VENDIMTAR PËR SUKSES NË PUNË	PO	JO
koeficienti më i lartë i inteligjencës	PO	JO
shkollat më të mira	PO	JO
profesioni më popullarizues	PO	JO
kënaqësia në punë	PO	JO
talenti	PO	JO
këmbëngulja	PO	JO

*1 pikë*

- 8.** Në atë kohë kam menduar se një përgjigje e këtillë është dredharake dhe e pakënaqshme. “Por, në çfarë të përqendrohëm?”, pyeta. “A duhet që të zgjedh ndonjë disiplinë funksionale, ndonjë specialitet industrial, ose diçka tjetër?” “Ajo varet nga ti” është përgjigjur ai. “Puno çfarë të duash me çka mund të kënaqesh. Mos merr atë me të cilën nuk do të kënaqesh, vetëm për shkak të asaj që mendon se ne jemi duke e kërkuar.”

**Cila nga fjalitë në vazhdim është përmbledhja më e mirë e paragrafit të dhënë?**

1. Sistemi funksionon ashtu që secili zgjedh punën që dëshiron.
2. Jeta private dhe ajo e biznesit shikohen si një dhe e njëjtë.
3. Suksesi i biznesit vjen nga dashuria për atë që bëjmë.

*Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë*

**Në bazë të fragmentit nga vepra zhvillo detyrat 9, 10, 11, 12 dhe 13.**

#### ANTIGONA

Këto urdhëresa nuk i dha Zeusi;  
edhe Drejtësija që banon te Hadi  
nuk ka vënë ligje si këto të tuat;  
as ndër mënd s’e shkonja se m’ato që çpalle,  
ti, njeri i vdekshëm, do guxonje sheshit  
të shkelësh të drejtat, të drejtat e hyjve.  
Të shkruara s’janë – është e vërtetë, -  
po në gjithë botën s’ka asnjë fuqi  
që të mund t’i tundë, t’i rrëzojë, t’i prishë  
këto s’janë gjëra që u çfaqën dje,  
as do jenë vetëm për sot e për nesër,  
forca e atyre do ngelë për jetë  
dhe nga kanë ardhur, nuk e di askush.  
Këto pra të drejta s’ka njeri në botë  
që të më shtrëngoje t’i marr nëpër këmbë  
dhe pastaj nga hyjtë të dënohem keq.  
Dinja që më parë, pa e çpallur ti,  
se më priste vdekja, po një vdekje e tillë,  
vdekje para kohe, do jetë për mua  
një e mirë e madhe, shpëtim i vërtetë.  
Se për një si unë që jetoj me vuajtje  
vdekja si nuk qenka një shpëtim i sigurt?



Unë asnjë dhembje s' ndjej për këtë fat  
dhembje do të kisha po të mos varrosnja  
tim vëlla, të cilin bash ajo e lindi  
që më lind'e mua. Ja kjo do m'helmonte;  
e sa për të tjerat, nuk më prekin fare,  
s' dua t'ja dij,  
në pra do më marrësh për ndonjë të marrë,  
e marrë i dukem vetëm një të marri

**9. A) Kush është autori i veprës nga e cila është fragmenti i dhënë?**

---

1 pikë

**B) Cilët lloj letrar i përket vepra nga e cila është dhënë fragmenti?**

---

1 pikë

**10. A) Në cilën periudhë historiko-letrare krijon autori i kësaj vepre?**

---

1 pikë

**B) Cilët shkrimtarë i përkasin të njëjtës periudhë historiko-letrare sikurse edhe autori i fragmentit?**

1. Homeri dhe Petrarka
2. Eskili dhe Aristofani
3. Dante dhe Euripidi

*Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.* 1 pikë

**11. Kujt i drejtohet Antigona në fragmentin e dhënë?**

---

1 pikë

**12.** Shpjegoje vetinë e Antigonës që vjen në shprehje në këtë fragment.

---

---

1 pikë

**13.** Si është ndëshkuar Antigona për shkak se kishte varrosur vëllain e saj?

---

---

1 pikë

**14.** Pranë emrit të personazhit letrar shkruaje titullin e veprës në të cilën paraqitet dhe gjininë letrare që i përket ajo.

(vepra)

(gjinia letrare)

Enkidui	_____	_____
Dr. Dhalla	_____	_____
Zeneli	_____	_____

3 pikë

**15.** A) Një fjalë e dhënë më poshtë nuk i përket klasës së njëjtë të fjalëve. Rretho numrin para asaj fjale.

1. ja
2. nëpër
3. pikërisht
4. mbase

1 pikë

B) Argumentoje përgjigjen nën A duke emëruar klasën e fjalëve.

---

---

1 pikë

**16.** Forma përcjellore e foljes punoj është:

---

1 pikë

**17.** *letrat, shkrimet didaktike, fabulat*

Në cilën periudhë historiko-letrare mbizotërojnë llojet e dhëna letrare?

---

1 pikë

Kujto ngjarjen dhe personazhet në veprën *I huaji* të A. Kamysë dhe përgjigju në pyetjet 18 dhe 19.

**18.** Fjala *I huaji*, që është edhe vetë titulli i veprës, është e lidhur në këtë vepër me një njeri, i cili:

1. Flet në gjuhë të huaj dhe të padëgjuar më parë.
2. Ndihet vazhdimisht i huaj në mjedisin ku jeton.
3. Vjen nga një vend shumë i largët dhe i huaj.

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

**19. Jeta e personazhit kryesor Merso paraqitet si një lojë e pamëshirshme midis:**

1. Absurdit dhe njeriut.
2. Kujtesës dhe harresës.
3. Realitetit dhe ëndrrës.

*Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë*

**20. Në bazë të fragmentit shkruaje titullin e veprës dhe autorin e saj.**

1. Flamujt e armikut njëmijë herë u ngritën majë ledheve; u zhvilluan përlëshje fytafyt edhe në zemër të qytetit; asnjë qytetar, i çfarëdo shkalle, nuk mbeti pa një plagë. Orvatej babai t'u jepte zemër djemve, vëllai vëllait, qytetari qytetarit, dhe, duke kaluar midis kufomave të të vetëve, turreshin mbi armikun.

---

*1 pikë*

2. Ajo u zverdh e na vështroi  
E u kthye dhe, sa e pa  
Shtrirë të vdekurin mbi dhe,  
Dha një britmë e në krahë  
E ftohtë si bora i ra.

---

*1 pikë*

3. Era ja puth gjinjtë e ia shpalos si kurorë  
Palët e velit që lehtas ia tund vala;  
Shelgu lotues i vajton mbi kraharor  
E mbi ballin e ftohtë mbuluar me stërkala

---

*1 pikë*

**21.**

**Shkruaje emrin e personazhit nga *Pas vdekjes* i cili i thotë vargjet e dhëna, si dhe emrin e personazhit me të cilin kanë të bëjnë vargjet, gjegjësisht kujt i drejtohen ato.**

1. Çudë! s'mund të marr vesh! Yt zot, Kryetar' i Klubit, më dha fjalë të piqemi këtu më 8 pas dreke, dhe ti më thuaj që s'ka dhe ardhë! I the, bre, se kush jam unë?

\_\_\_\_\_

*(personazhi që i thotë vargjet)*

\_\_\_\_\_

*(personazhi me të cilin lidhen vargjet)*

1 pikë

2. Qysh! Po e ka vendosur Kongres' i Manastirit...

\_\_\_\_\_

*(personazhi që i thotë vargjet)*

\_\_\_\_\_

*(personazhi me të cilin lidhen vargjet)*

1 pikë

3. Thuaj si të duash: nukë do të më vinte mirë fare, unë gjall' e me të gjallë, të kem gati shkrimin e vdekjes!

\_\_\_\_\_

*(personazhi që i thotë vargjet)*

\_\_\_\_\_

*(personazhi me të cilin lidhen vargjet)*

1 pikë

**Lexo fragmentet nga romani *Krimi dhe ndëshkimi* (F. M. Dostojevski) pastaj përgjigju në pyetjet 22, 23, 24 dhe 25.**

E vërteta, këtë herë frika e takimit me kreditoren e tij e befasoi edhe atë pasi ai doli në rrugë.

“Për çfarë hapi duhet të vendosem, dhe në të njëjtën kohë, nga të cilat situata kam frikë!”, mendova me një buzëqeshje të çuditshme. “Hëm... po... e gjitha është në duart e njeriut, dhe gjithçka i ik para hundës vetëm për shkak të frikës ... ajo është aksioma ... Dhe është interesant se nga çfarë njerëzit kanë më shumë frikë!... Hapit

të ri dhe fjalës së tyre të re u frikësohen më së shumti... Pra, pse po shkoj tani? A jam i aftë për këtë? A është kjo serioze? Nuk është aspak serioze.” (...)

Sonja duartrokiti.

- Me të vërtetë a është e saktë, a është me të vërtetë e saktë? Zot, çfarë lloj e të së vërtetës është kjo! Kush mund ta besojë atë?... Dhe si, si atë, ju vetë jepni gjënë e fundit që keni, dhe keni vrarë që të plaçkitni! Dhe!...- klithi ajo njësh – ato para që i keni dhënë Katarina Ivanovës... ato para ... Zot, ndofta nuk janë edhe ato para...

- Jo, Sonja – shpejt e ndërpreu ai – ato para nuk ishin ato, mos u frikëso! Ato para m'i ka dërguar nëna ime, nëpërmes një tregtari, dhe i mora, i sëmurë, të njëjtën ditë kur edhe i kam dhënë ... Razumihin e pa këtë ... ai i mori në vendin tim ... ato para janë të miat, personalisht të miat, vetëm të miat.

Sonja e dëgjonte atë e hutuar dhe me gjithë forcën që kishte përpiqej të kuptonte diçka.

- Dhe ato para ... unë, në fund të fundit, edhe nuk e di nëse atje ka pasur para – shtoi ai me zë të ulët dhe sikur të duke u menduar... – i hoqa portofolin e saj nga qafa, nga lëkura plot qime... përplot, portofolin e ngjeshur... por as që shikova në të; duhet të mos kam pasur kur... Dhe gjërat, të gjitha disa mbërthecka dhe zinxhir – të gjitha ato gjëra dhe portofoli në një oborr të huaj, në prospektin Voskresenski, nën një gur të fshehura, menjëherë të nesërmen... Të gjitha edhe tani qëndrojnë atje...

Sonja e dëgjonte me shumë kujdes. (...)

- Dhe çfarë ke ti, çfarë ke ti nga ajo – bërtiti ajo pas një çasti madje, me një dëshpërim – çfarë ke ti nga ajo, që unë tani të pranoj se kam bërë një gjë të keqe? Çfarë ke nga ky triumf i marrë mbi mua? Ah, Sonja, a kam ardhur tek ti për këtë arsye!

Sonja sikur përsëri dëshironte të thoshte diçka, por heshti.

- Për atë arsye të thirra dje të vish me mua, që tani vetëm ti më ke mbetur.

- Ku më ke thirrur? – e frikësuar e pyeti Sonja.

- Jo që të vjedhim, dhe as të vrasim, mos u frikëso, jo për atë – u qesh ai – unë dhe ti jemi – njerëz të ndryshëm... Dhe, e di, Sonja, unë vetëm tani, vetëm këtë çast të kam kuptuar ku të kam thirrur dje! Dhe dje, kur të kam thirrur, as vetëm nuk e kam kuptuar ku po të thërras. Për një gjë të kam thirrur, vetëm për një gjë të vetme edhe kam ardhur: që të mos më lësh. Nuk do të më lësh, apo Sonja?

Ajo ia shtrëngoi dorën. (...)

Ajo u ndal dhe u mendua pak.

- Eh, ajo unë dhe ti jemi njerëz krejtësisht të ndryshëm! – bërtiti përsëri ai. – Nuk jemi njëri për tjetrin. Dhe përse, përse të kam ardhur! Askurrë nuk do t'ia falë vetes!

- Jo, jo, bash është mirë që erdhe! – klithi Sonja. – Është më mirë që edhe unë të di! Shumë më mirë!

**22.** Me cilat forma të shprehjeve artistike e pikturon Dostojevski gjendjen psikologjike të personazheve në fragmente?

Raskoljnikovi: \_\_\_\_\_  
1 pikë

Sonja: \_\_\_\_\_  
1 pikë

**23.** Sonja është e hutuar dhe e frikësuar me veprimin e Raskoljnikovit. Në bazë të çfarë e nxjerrim këtë përfundim?

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
2 pikë

**24.** Gjendja psikologjike e Raskoljnikovit është e ndryshueshme. Duke u bazuar në tekst, dëshmoje këtë konstatim.

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
2 pikë

**25.** Çfarë ndjenje tregon Sonja ndaj Raskoljnikovit në fragmentet e dhëna? Argumento përgjigjen.

\_\_\_\_\_  
2 pikë

**26.** Foljet e nënvizuara në fjalinë: Shko e mos eja, janë në mënyrën:

\_\_\_\_\_  
1 pikë

- 27.** A) Foljen e nënvizuar në fjalinë: *Kúr kem pasë besë me kraji*, shkruaje në normën letrare dhe përcaktoja mënyrën, kohën dhe formën e saj.

kem pasë /  
norma letrare \_\_\_\_\_  
mënyra \_\_\_\_\_  
koha \_\_\_\_\_  
forma \_\_\_\_\_

1 pikë

- B) Shkruaje në trajtën e pashquar, në numrin njëjës, në rasën rrjedhore, emrin veturë.

\_\_\_\_\_

1 pikë

- 28.** *Ukë, periudhë, automobil, linjë, viadukt, luan.*

Përshkruaji emrat e gjinisë mashkullore.

\_\_\_\_\_

1 pikë

- 29.** A) Përshkruaje fjalën e cila nuk i përket vargut të dhënë.

kufiri      druri      peni      freri

\_\_\_\_\_

1 pikë

- B) Argumentoje përgjigjen.

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

1 pikë



**30.**

Janë ofruar dy tema për hartimin e esesë. Rrethoje numrin para temës që do ta zhvillosh. Eseja duhet të përmbajë 250 deri në 300 fjalë.

Hartoje atë si tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin. Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHEM FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi).

Gjatë hartimit të esesë kij kujdes për mënyrën e të shprehurit dhe për zbatimin e normave drejtshkrimore. Shkruaj lexueshëm.

## **1. Analiza e romanit të mohimit *Nga jeta në jetë-pse?!***

**Udhëzime për shkrimin e esesë.**  
**Shkruaj për:**

- Temat kryesore që trajton ky roman.
- Subjektin e veprës.
- Kryepersonazhin dhe konfliktin e tij:
  - problemet që e mendojnë kryepersonazhin, përmendi personazhet e tjerë dhe fatin e tyre;
  - sjelljen e personazhit kryesor, ku e gjen shpëtimin ai, për çfarë përcaktohet në këtë rast dhe pse e bën këtë?

## **2. Për teatrin nga këndvështrimi im**

**Udhëzime për shkrimin e esesë.**

- Çfarë vendi ka teatri në mes të medimeve bashkëkohore? Arsyetoje përgjigjen tënde.
- Jepe mendimin tënd për pozitën e kulturës dhe pasurinë e ngjarjeve kulturore në mjedisin ku jeton. Argumentoje qëndrimin tënd.
- Sqaroje dallimin në mes artit teatral dhe disa formave tjera të artit.
- Shkruaje cilën vepër dramatike që e ke lexuar si tekst do të dëshiroje që ta shikosh si shfaqje teatrale. Sqaroje për cilën arsye e ke zgjedhur atë vepër.
- Jepe në formë të argumentuar qëndrimin tënd për atë nëse na nevojitet teatri?

25 pikë















1.

2.

3.

4.

5.

6.

7.

8.

9.

10.

11.

12.

13.

14.

15.

1.  
2.  
3.  
4.  
5.  
6.  
7.  
8.  
9.  
10.  
11.  
12.  
13.  
14.  
15.  
16.  
17.  
18.

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9  
10 11 12 13 14 15 16 17 18 19